

## Nxitja e integruar (IF)

Informacion për prindërit

### **Së bashku në të njëjtën klasë**

Nxitja e integruar (IF) është një mbështetje për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë e një klase.

Mësuesi i klasës dhe një mësues-IF me shkollim të veçantë punojnë ngushtë bashkë.

Fëmijët gjejnë mbështetje në klasë, në grupe dhe në mënyrë individuale në fushat që vijojnë:

- Vështirësi në të mësuar
- Aftësi të veçanta
- Probleme në sjellje

Gjermanisht si gjuhë e dytë (DaZ) do të ofrohet - sipas komunës – në kuadrin e IF ose e ndarë.

Mësuesit mund të planifikojë masat e nxitjes në një marrëveshje për nxitjen. Ata bisedojnë së bashku me fëmijën dhe prindërit për masat e nxitjes. Fëmijët të cilët me ndihmën e IF i arrijnë qëllimet mësimore të planit mësimor, do të vlerësohen me sistemin e zakonshëm të notave.

### **Qëllime mësimore dhe vlerësim individual**

Në rast se fëmijët dhe të rinjtë me gjithë përkrahjen intensive nuk i arrijnë qëllimet standarte të planit mësimor, atyre iu jepen "qëllime mësimore individuale"- të përshtatura me mundësitë e tyre. Për këto bisedohet së bashku me fëmijën dhe prindërit dhe me anë të një marrëveshjeje bëhen të vendosura. Në rast se është e nevojshme mund të kërkohet ndihma e Shërbimit psikologjik shkollor. Në rastet e mospajtitit vendos Drejtoria shkollore.

Në rastet e reduktimit të qëllimeve mësimore, fëmijët dhe të rinjtë marrin në këto lëndë në vend të notave një përshkrim për të nxënin. Në dëftesë shënohet tek lënda përkatëse „vizituar“. Tek vërejtjet administrative shkruhet: „Nxitje e integruar; qëllime mësimore individuale“. Fëmijët me aftësi të veçanta dhe qëllime mësimore të zgjeruara marrin përveç notave të rregullta edhe një përshkrim për të nxënin.

### **Prindërit dhe shkolla: Mbajnë së bashku përgjegjësinë**

- Mënyra se si i shikojnë prindërit është një bazë e rëndësishme për masat e nxitjes.
- Prindërit i përmbahen gjithashtu masave që janë vendosur dhe e përkrahin shkollën.
- Ata marrin pjesë në bisedat vlerësuese dhe në bisedat e përcaktimit të situatës. Këto zhvillohen, për rastet me qëllime mësimore individuale, dy herë në vit.
- Ata merren vesht me shkollën për qëllime mësimore individuale për fëmijën e tyre, në rast se këto janë të domosdoshme.
- Ata kanë të drejtë, që në rastet e mosmarrëveshjes të dëgjohen nga drejtoria e shkollës.

### **Kush jep sqarime?**

- Personi i parë ku mund të drejtohesh është mësuesi i klasës ose mësuesja e klasës.
- Mësuesi-IF mund të pyetet në rastet e pyetjeve për të mësuarin ose sjelljen.
- Tek drejtoria e shkollës mund të drejtohesh, kur mësuesit dhe prindërit nuk janë të një mendimi.

Maj 2011